

Bazuar në nenin 36, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, Bordi Ekzekutiv i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 gusht 2020, miratoi këtë:

## UDHËZUES PËR RISTRUKTURIM TË KREDIVE PËR SHKAK TË COVID-19

### Neni 1 Qëllimi dhe fushëveprimi

1. Qëllimi i këtij udhëzuesi është që t'u ofrojë kredimarrësve, kredidhënësve dhe institucioneve tjera, informacion lidhur me parimet dhe udhëzimet që kanë të bëjnë me procesin e ristrukturimit të kredive. Qëllimi i udhëzuesit është vendosja e kriterëve mbi të cilat duhet të bazohet procesi i ristrukturimit të kredisë, në mënyrë që kredimarrësit në vështirësi financiare të kenë mundësinë të përmbushin detyrimet e parapara me kontratë, dhe me qëllim të rikthimit në normalitet të aktivitetit të tyre biznesor apo përmirësimit të aftësisë paguese të individëve në raport me obligimet aktuale. Me këtë udhëzues, BQK-ja udhëzon institucionet kredidhënëse, që gjatë periudhës së rimëkëmbjes ekonomike për shkak të Covid-19, të mos angazhohen në likuidimin e kolateralit, duke përdorur mekanizma jashtë gjykatës dhe/ose procedura ligjore për kreditë e ristrukturuara sipas këtij udhëzuesi.
2. Ky udhëzues aplikohet për të gjitha institucionet financiare të licencuara/regjistruara nga BQK-ja për të ushtruar aktivitet të kredidhënies sipas legjislacionit në fuqi.

### Neni 2 Definicionet

1. Për qëllime të këtij udhëzuesi, shprehjet e përdorura kanë kuptimin si më poshtë:

1.1 "Ristrukturimi i kredisë" - është lehtësimi që institucionet kredidhënëse bëjnë për kredimarrësit për shkak të vështirësive financiare të tyre të shkaktuara nga Covid-19 dhe përkrahjen për rimëkëmbjen e tyre. Këto masa (apo lehtësime) përfshijnë:

1.1.1 lehtësimet e bëra në kushtet e kredisë nëpërmjet ndryshimit të një ose disa kushteve të kontratës, të cilat lidhen kryesisht me afatin (duke përfshirë grace periudhën për fillimin e pagesës së kredisë), kryegjënë dhe normën e interesit (duke mos përfshirë kapitalizimin e interesit, i cili nuk duhet të ndodhë);

1.1.2 marrjen e kolateralit apo asetëve (pasurive) tjera për shlyerjen e pjeshme të kredisë;

1.1.3 zëvendësimin e kredimarrësit fillestar ose përfshirjen e një kredimarrësi shtesë.

1.2 “Kredimarrës” (debitorë dhe/ose bashkëdebitorë) - janë personat fizikë ose juridikë, të cilët kanë marrë kredi apo ndonjë produkt tjetër të financimit dhe kanë obligime të papaguara ndaj institucionit kredidhënës.

1.3 “Kredidhënës” - janë bankat dhe institucionet financiare të licencuara nga BQK-ja për kredidhënie.

1.4 “Moratorium” - është ndërprerja e përkohshme e veprimeve ligjore kundrejt palës tjetër dhe ndërprerja e përkohshme e obligimeve për pagesën e kredisë.

### **Neni 3**

#### **Ristrukturimi i kredive**

1. Ristrukturimi i kredive duhet të bëhet në mënyrë të kujdesshme me qëllim që modifikimet e kredive që ristrukturohen të jenë në interesin më të mirë të institucionit kredidhënës dhe kredimarrësit, me qëllim të përmirësimit të performancës së kredisë, në njërën anë dhe uljen e rrezikut kreditor në anën tjetër. Institucionet kredidhënëse udhëzohen të ristrukturojnë kreditë dhe të përdorin fleksibilitet përbrenda kornizës së kontabilitetit për të shmangur ndëshkime të padrejta ndaj kredimarrësve të prekur me probleme afatshkurtra të likuiditetit; ato gjithashtu duhet të sigurojnë që humbjet të mos jenë të fshehura dhe standardet prudenciale të mos relaksohen. Ristrukturimi nuk do të thotë domosdoshmërisht dështim i kredimarrësit duke interpretuar në mënyrë të arsyeshme kërkesat rregullatore, dhe nuk është e nevojshme që transaksioni të konsiderohet si i dëmtuar në kornizën e kontabilitetit nëse pas ristrukturimit kredimarrësi nuk është në vështirësi financiare dhe / ose vlera e tanishme neto e kredisë nuk është zvogëluar. Në rastet kur institucionet kreditore u japin kredi të reja apo rrisin ekspozimin aktual të kredimarrësve që janë subjekt i ristrukturimit të kredive, nuk do të thotë që automatikisht ekspozimi të klasifikohet si i dështuar. Kreditë të cilave i është aprovuar moratoriumi pas datës 16 mars 2020 janë subjekt i këtij udhëzuesi dhe mund të ristrukturohen në pajtim me këtë udhëzues.
2. Për shkak të ndikimit të madh të Covid-19 në ekonomi dhe në performancën e kredimarrësve, institucionet kredidhënëse udhëzohen të bëjnë ristrukturimin e kredive me qëllim të:
  - 2.1 Lehtësimit të shtyrjes së pagesave të kredive për individët dhe kompanitë në vështirësi financiare që t’u mundësohet vazhdimi i veprimtarisë dhe tejkalimit të vështirësive financiare;
  - 2.2 Dhënies së mundësive për institucionet kredidhënëse për të zvogëluar humbjet;
  - 2.3 Krijimit të mundësive për shmangien e ndikimeve negative sociale dhe ekonomike, të cilat mund të lindin si rrjedhojë e falimentimit të kompanive;
  - 2.4 Përkrahjes së palëve të tjera të interesit (klientët, punonjësit, furnitorët dhe investuesit), sepse kredimarrësit e përfshirë në ristrukturimin e kredisë mund të vazhdojnë biznesin e tyre; dhe
  - 2.5 Shmangies së procesit gjyqësor, i cili mund të kërkojë kohë deri në përfundimin e tij, si dhe rritjes së efikasitetit të mbledhjes së kredive.
3. BQK-ja udhëzon institucionet kredidhënëse të punojnë në mënyrë konstruktive me kredimarrësit që ristrukturimi të jetë i kujdesshëm dhe me kushte të përshtatshme.

4. Kredimarrësit mund të kërkojnë nga kredidhënësit e tyre ristrukturim të kredisë, nëse ata kualifikohen.
5. Institucionet kredidhënëse që ofrojnë lehtësim të kushteve të kredisë sipas këtij udhëzuesi duhet të përpilojnë politika për zbatimin e këtyre lehtësirave. Vendimi për aplikimin/zbatimin e këtyre lehtësirave është vendim biznesor i institucioneve kredidhënëse, bazuar në vlerësimin e kapacitetit të kredimarrësit për të paguar sipas kushteve të reja të modifikuara.
6. Institucioneve kredidhënëse u lejohet të bëjnë ristrukturimin për kredimarrësit, të cilët gjatë vlerësimit të institucioneve kredidhënëse, janë prekur negativisht nga pandemia e Covid-19. Një ristrukturim i tillë i dhënë duhet të bëhet sipas këtyre përcaktimeve:
  - 6.1 Të përfshijë ndryshime në afatin e ripagimeve përmes pezullimit, shtyrjes ose zvogëlimit të shumave të principalit, interesit ose pagesave të plota, siç është rënë dakord midis institucionit kredidhënës dhe kredimarrësit duke marrë parasysh aftësinë e klientit për të tejkaluar vështirësitë e përkohshme financiare;
  - 6.2 Interesi i rregullt i përllogaritur gjatë periudhës së pezullimit, do të shpërndahet gjatë minimum 6 muajve të ardhshëm, apo deri në maturitet, në rast se afati i maturimit të kredisë është më i vogël se 6 muaj.
  - 6.3 Ristrukturimi apo lehtësimi i pagesës së kësteve të kredisë (grace periudhë, principal më i vogël, e të ngjashme) nuk mund të jepet për një periudhë më të gjatë se 12 muaj. Kërkesat për ristrukturim duhet të bëhen dhe pranohen deri më 30 shtator 2020.
  - 6.4 Ristrukturimi i kredisë nuk nënkupton domosdoshmërisht që kredimarrësi ka dështuar dhe transaksioni të klasifikohet dhe konsiderohet si joperformues. Institucionet kredidhënëse duhet të numërojnë ditët e vonesës duke u bazuar në planin e ri të pagesës që rezulton nga aplikimi i moratoriumit.
  - 6.5 Duke pasur parasysh shkallën e lartë të ristrukturimit që përfshin moratoriumi i borxhit dhe prioritetit të lartë të çështjeve që kanë të bëjnë me vazhdimësinë e biznesit gjatë krizës, është e kuptueshme që bankat mund të mos jenë në gjendje, që në afat të shkurtër, të vlerësojnë ndikimin e krizës tek kredimarrësit e tyre dhe aftësinë paguese për të shlyer detyrimet e tyre, duke marrë parasysh efektin e moratoriumit të borxhit.
  - 6.6 Përderisa institucionet kredidhënëse marrin më shumë informacion të sigurt dhe të besueshëm mbi gjendjen financiare të kredimarrësve dhe aftësinë e tyre për të kryer pagesat, bazuar në kushtet e modifikuara të kredisë, ato duhet të vlerësojnë nëse ka nevojë për të ndryshuar klasifikimin e kredisë dhe për të vlerësuar humbjet e pritura të kredisë. Një institucion kredidhënëse mund të përdorë qasje individuale ose kolektive të vlerësimit të *humbjeve të pritura të kreditorëve* (HPK), në varësi të mënyrës se si institucioni kredidhënës menaxhon ekspozimet ndaj rrezikut të kredisë.
  - 6.7 Institucionet kredidhënëse duhet të sigurojnë që procedurat e përdorura për të matur HPK-të, pavarësisht nëse përcaktohen në mënyrë kolektive ose individuale, janë të shëndosha dhe me kohë, si dhe duhet të marrin parasysh kritere të ndryshme siç janë zbutësit shtesë të rrezikut të kredisë (p.sh. garancitë), vlerësimet e rrjedhës së parave, bazuar në vlerësimet e kushteve makroekonomike dhe situata (pozicioni financiar) e kredimarrësit pas krizës, së bashku me informacione të tjera të rëndësishme për të ardhmen, të cilat ndikojnë në mbledhjen e pritshme të ekspozimit të kredisë së bankës.

6.8 Institucionet kredidhënëse duhet të bëjnë shpalosje të qarta dhe të hollësishme mbi kriteret e përdorura për të përcaktuar klasifikimin e kredisë, si dhe supozimet dhe skenarët e bërë në vlerësimin e mjaftueshmërisë së provizioneve të humbjes së kredisë.

6.9 Institucionet kredidhënëse do të duhet të ushtrojnë gjykim të shëndoshë në zbatimin e Standardit Ndërkombëtar të Raportimit Financiar 9 (SNRF 9) veçanërisht në këtë kohë kur ekziston një situatë e konsiderueshme e pasigurisë. Në mjedisin aktual ekonomik, vlerësimi i HPK-ve duhet të marrë parasysh natyrën e përkohshme të ndikimit të Covid-19, informacionin më të mirë të disponueshëm, masat përkatëse të mbështetjes fiskale dhe përdorimin e një sërë skenarëve për të mbështetur analizën e rrezikut të kredisë, duke përfshirë skenarin e pafavorshëm në situatën aktuale. Në të njëjtën kohë, institucionet kredidhënëse duhet ta kenë parasysh se SNRF 9 është i bazuar në parime dhe për këtë arsye nuk duhet të zbatohet mekanikisht dhe të shmangë aplikimin automatik. Për shembull, moratoriumi nuk duhet të rezultojë automatikisht në lëvizjen e ekspozimeve të rrezikut të kredisë në fazën 2 pasi kjo nuk nënkupton domosdoshmërisht që ka pasur një rritje të konsiderueshme të rrezikut të kredisë.

6.10 Institucionet kredidhënëse duhet të zbatojnë parimet udhëzuese “SNRF 9 dhe Covid-19” për aplikimin e HPK sipas SNRF 9 të publikuara më 27 mars 2020 nga Fondacioni i SNRF-ve.

6.11 Në rast të vonesave në kthimin e kredisë, sipas planit të ri të pagesës pas ristrukturimit, institucionet kredidhënëse janë të obliguara të zbatojnë kërkesat e rregulloreve të BQK-së në fuqi.


6.12 Ristrukturimi i kredive mund të ofrohet nga institucionet kredidhënëse apo mund të kërkohet nga kredimarrësit.

#### **Neni 4 Shfuqizimi**

Me hyrjen në fuqi të këtij udhëzuesi, shfuqizohet Udhëzuesi për Ristrukturim të Kredive për Shkak të Covid-19, i miratuar nga Bordi Ekzekutiv më 8 qershor 2020.

#### **Neni 5 Hyrja në fuqi**

Ky udhëzues hyn në fuqi në datën e miratimit.



Fehmi Mehmeti  
Kryesues i Bordit Ekzekutiv

#### **Udhëzuesi u dërgohet:**

- Departamentit të Mbikëqyrjes Bankare (DMB) dhe Departamentit të Marrëdhënieve me Jashtë (DMJ)
- Institucioneve për të cilat është i aplikueshëm (t'u dërgohet udhëzuesi në mënyrë elektronike nga DMB)
- Publikut të gjerë (të publikohet udhëzuesi në faqen e internetit të BQK-së nga DMJ)